



Në pajtim me nenin 5, nenin 6, nenin 56, nenin 59 paragrafi 1 dhe nenin 62 të Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minalet, Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2015 nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV

(KPMU UA. Nr. 01/2016)

PËR BASHKIM TË LICENCEVE

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është rregullimi dhe përcaktimi i çështjes së bashkimit të licenceve dhe i mënyrës së paraqitjes të kërkesës për bashkimin e licenceve për ndërmarrjet të cilat posedojnë licenca për shfrytëzimin e mineraleve.
2. Poashtu, me anë këtij udhëzimi përcaktohen rregullat, procedurat dhe afatet, të cilat do të ndjek KPMU kur ka të bëjë me kërkesa për bashkim të licenceve nga çdo bartës i licenceve për shfrytëzim.

Neni 2

Fushëveprimi

Ky udhëzim Administrativ zbatohet nga KPMU në të gjitha rastet kur ka të bëjë me kërkesa të ndërmarrjeve për bashkimin e licenceve, dhe me të përcaktohen kriteret dhe kushtet që duhet plotësuar për bashkimin e licenceve dhe procedurat dhe formën e lëshimit të licenceve në rastet kur ka kërkesa për bashkimin e dy apo me shume licenceve.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativë kanë këtë kuptim:

1.1. KPMU- nënkupton Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale;

- 1.2. **Bashkim i licencave**– nënkupton bashkimin e dy apo më shume licencave në një licencë.
- 1.3. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë përkufizimet e përcaktuar me Ligjin Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale (i ndryshuar me Ligjin Nr.04/L-158)

Neni 4

E drejta për paraqitjen e kërkesës

Të drejtë për paraqitjen e kërkesës për bashkimin e licencave e ka çdo ndërmarrje e cila posedon licencë të vlefshme për shfrytëzimin e mineraleve nga KPMM dhe e cila i plotëson kushtet që parashihen me këtë udhëzim administrativ.

Neni 5

Kriteret e Aplikimit për Bashkim të Licencave

1. KPMM ka përgatitur një aplikacion ku specifikohet se cilat prej dokumenteve duhet t'i paraqesin ndërmarrjet të cilat janë të interesuara për të aplikuar për bashkim të licencave.
2. Me rastin e aplikimit për bashkim të licencave ndërmarrja duhet të sjell këto dokumente:
 - 2.1. Formularin e përgatitur nga KPMM për bashkimin e licencave.
 - 2.2. Koordinatat e kufirit të jashtëm për të cilat kërkohet bashkimi i licencave (në CD dhe letër të vërtetuar).
 - 2.3. Situacioni gjeodezik (gjendja momentale e terrenit) për tërë sipërfaqen ku kërkohet bashkimi i licencave (në CD dhe letër me shënimet e matjeve origjinale).
 - 2.4. Një elaborat Gjeologjik plotësues për tërë sipërfaqen sipas paragrafit 4.3.2. më të dhënat e më poshtme.
 - a. Hartën e situacionit për tërë zonën që aplikon në të cilën duhet të bëhen të dallueshme pjesët e shfrytëzuara
 - b. Një përshkrim të rezervave sipas elaborateve paraprake në bazë të cilave është licencuar
 - c. Sasia e rezervave të shfrytëzuara sipas licencave paraprake të shfrytëzimit
 - d. Mbetje e rezervave gjeologjike dhe të shfrytëzueshme në licencat paraprake

- e. Llogaritje e rezervave ekzistuese në tërë sipërfaqet e aplikuar për bashkim të licencave.
3. Një Projekt Plotësues të Shfrytëzimit, i cili duhet të jetë i punuar në përputhje me Rregulloret aplikueshme për hartim të Projekteve të Shfrytëzimit.

Neni 6

Kushtet për bashkimin e licencave

1. KPMM aprovon Bashkimin e Licencave nëse pala i ka plotësuar kriteret e përcaktuar në licencën të parashikuar me Ligjin nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale dhe Ligjin nr. 04/L-158 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Miniera dhe Minerale si dhe kriteret e përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ.
2. KPMM aprovon Bashkimin e Licencave nëse pala ka dy apo më shumë Licenca ekzistuese dhe që fizikisht kufizohen me njëra tjetrën.
3. KPMM mund të aprovoj Bashkimin e Licencave në një licencë të vetme, me kusht që bartësi i licencës të përmbush kushtet për licencën e rene përputhje me LMM dhe këtë UA ..
4. Afati i licencës përcaktohet në bazë të projektit të shfrytëzimit sipas nenit 5 paragrafi 3.
5. Në ato raste kur aplikacioni për bashkimin e licencave ka kohëzgjatje më të madh sesa kohëzgjatja e licencave paraprake, ndërmarrja, duhet të paguaj ndryshimin e garancionit banakar në raport me sipërfaqen dhe afatin e licencës së bashkuar.
6. Sipërfaqja e krijuar pas bashkimit të licencave, duhet të vazhdojë të plotësojë të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe duhet të vazhdojë të përmbahet edhe kufizimeve apo ndalimeve që parasheh legjislacioni në fuqi.

Neni 7

Shqyrtimi i kërkesës

1. Pas pranimit të aplikacionit nga KPMM, departamentet përkatëse shqyrtojnë aplikacionin në pajtim me LMM dhe Udhëzimin Administrativ për Shqyrtimin e aplikacioneve për Licenca dhe Leje.
2. Pas përpunimit të aplikacionit nga departamentet përkatëse të cilat janë të obliguar që të përgatisin raportin në pajtim me Ligjin Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale (i ndryshuar me Ligjin Nr.04/L-158) dhe këtë udhëzim administrativ, aplikacioni për bashkimin e licencave i paraqitet Bordit të KPMM-së për shqyrtim.

Neni 8
Afati për shqyrtimin e aplikacioneve

1. Afati për shqyrtimin e aplikacionit për bashkim të licencave është i njëjte me afatin për shqyrtimin e aplikacioneve për licencat e Shfrytëzimit e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Minierat dhe Minerale.

Nenin 9
Efekti i licencës për Bashkim

1. Me rastin e aprovimit të aplikacionit për bashkim të licencës nga Bordi i KPMM-së, ndërmarrjes së pajisur me licencë do i lëshohet një licencë e re. Licenca e re përfshin edhe zonën e licencave për të cilat ndërmarrja ka kërkuar bashkim.

2. Me rastin e aprovimit të bashkimit të licencave, licencat për të cilat është kërkuar bashkimi shfuqizohen”.

Neni 10
Dispozitat kalimtare

1. Me rastin e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi të gjitha aplikacionet të cilat janë në procedurë shqyrtohet në pajtim me këtë udhëzim.

2. Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.


Musa Shabani
Kryesues i Bordit
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale